



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 05.04.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“OBJEKT 3 KATE ME FUNKSION HOTELERI DHE SHËRBIME H BOUTIQUE”, ME
VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues “H-Boutique” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Objekt 3 kate me funksion hoteleri dhe shërbime “H Boutique”, me vendndodhje në fshatin Borsh, Bashkia Himarë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “H-Boutique” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I MJEDISIT DHE TURIZMIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR/SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nëshkruar më datë 30.07/2024